

“NIKI REC” SH.P.K. SHTIME

RAPORT



I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

PËR QENDREN GRUMBULLUESE TE MBETURINAVE METALIKE

NË MUZEQINE, SHTIME



QERSHOR, 2025



“NIKI REC” SH.P.K. SHTIME



RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR QENDREN GRUMBULLUESE TË MBETURINAVE METALIKE
NË MUZEQINE, SHTIME

Hartues i VNM-së:

Dr.sc.Raif Bytyçi, inxh.i mjedisit, person fizik i licencuar

Aplikon për Pëlqim Mjedisor:
“NIKI REC” SH.P.K.

Qershor, 2025





PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. Baza ligjore per hartimin e raportit	6
2.1. Rregullativa ligjore për hartimin e VNM-së	6
2.2. Metodologjia e punës	8
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISI	10
3.1. Përshkrimi i lokacionit	10
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit	12
3.3. Përshkrimi i aktiviteve ne qendren per grumbullimin e mbeturinave metalike	15
3.4. Proceset që kryhen në qëndren grumbulluese	16
3.5. Vlera investive e qendres per grumbullimin e mbeturinave metalike	17
5. VLERSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	18
5.1. Pershkrimi i Mjedisit	18
5.2. Relievi	18
5.3. Hidrogjeologjia	19
5.4. Pedologjia	19
5.5. Natyra dhe biodiversiteti	19
5.6. Bimesia dhe vegjetacioni	19
5.7. Bota shatzore-fauna	20
5.8. Peisazhi	20
5.9. Zhurma	20
6. MASAT PER ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NE MJEDIS	21
6.1. Ndikimet në vendbanim dhe popullatë	21
6.2. Ndikimi ne ndotjen e ujit dhe tokës	21
6.3. Ndikimi ne ndotjen e ajrit	21
6.4. Mbeturinat e Ngurta	22
6.5. Ndikimet ne Peisazh	22
6.6. Ndikimet ne Flore dhe Faune	22
7. MASAT PER MBROJTJEN E MEJDISIT	23
7.1. Masat parandaluese	23
7.2. Masat parandaluese per zvogelimin e ndikime ne toke dhe uje	23
8. PROGRAMI MONITORIMIT	24
9. MASAT REHABILITUESE PAS MBYLLJES SE VEPRIMTARISE	25
9.1 Rikultivimi teknik	25



9.2 Rikultivimi agroteknik.....	25
9.3 Rikultivimi biologjik	26
10. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE	27
11. PERFUNDIMI	29
12. LITERATURA	30
SHTOJCA	32



1. Hyrje

Vlerësimi i ndikimit ne mjedis -VNM siguronë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve.

Ky raport përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative



të projekteve të propozuara publike dhe private; Ky raport është një kategori ligjore dhe obligative për marrjen e pëlqimit mjedisor për të gjitha veprimtaritë dhe subjektet e ndryshme ekonomike që në një mënyrë apo tjetër e ndikojnë mjedisin e gjere, dhe paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor nga autoritetet përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinorë si kusht për marrjen e lejes për fillimin e veprimtarisë për ngritjen e qendres grumbulluese për mbeturinat metalike

Raporti i vlerësimit të ndikimit ne mjedis për qendrën grumbulluese për mbeturinat metalike me pronar Naser Salihaj me numer personal 1005577698, gjendet në Muzeqinë, Komuna e Shtimes buze rrugës tranzitore që lidhë Shtimen me Ferizajn dhe Shtimen me Prishtinën dhe paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e kësaj leje. Përmes këtij raporti do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në mjedisin jetësor dhe në mjedisin e gjerë në përgjithësi nga ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i veprimtarisë në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit dhe që impakti negativ mjedisor të jetë sa më i vogël. Ky raport është punuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku planifikohet të zhvillohet kjo veprimtari si dhe dokumentacionit teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjër në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së aktiviteteve të ndërtimit, ushtrimit të kësaj veprimtarie dhe pas përfundimit të aktivitetit të veprimtarisë.



2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VNM-se

Raporti i VNM-së është hartuar në bazë të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 (2023), i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së. Ky Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim qe të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve edhe atë:



- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore për hartimin e VNM-së

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për qendren grumbulluese te mbeturinave metalike në Muzeqine, Shtime - janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara si më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197





- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK)- NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbetur.
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturine.

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti për qendren grumbulluese të mbeturinave metalike dhe gjendja reale
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata e pronësisë
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit, nga gjeodeti i licencuar
- Pëlqimi i komunal për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas PZHK

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënëuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).



2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

- Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:
 - burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
 - popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
 - karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.
 - klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
 - kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
 - bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.
- Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve
 - madhësia dhe lloji i ndotjes
 - karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
 - gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
 - vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.
- Analiza e rrezikimit të
 - njeriut
 - vlerave materiale
 - vlerave natyrore.
- Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin e qendres grumbulluese të mbeturinave metalike në Muzeqine, Shtime.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

- *Objektivi i VNM-së*

Objektivi raportit të VNM-së është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Kosovës, të projekteve të propozuara, private apo publike. Pra objektivat duhet të jenë: specifike, të matshme, të arritshme, reale.

Të përcaktuara në kohë:



- *Fusha e zbatimit të VNM-së*

Hartimi i vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis në formën fillestare merret në konsiderim për t'u zbatuar për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtëpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

- *Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të një projekti*



Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshinë përcaktimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtëpërdrejta dhe jo të drejtëpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshinë përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij sipas rastit edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë dhe dekontaminimin, pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshinë, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshinë, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

- *Qëllimi i projektit*

Qëllimi primar i këtij projekti është që të krijoj të mira materiale përmes kësaj veprimtarie biznesore, por pa e dëmtuar dhe ndikuar negativisht mjedisin e gjerë. Parashikimet potenciale të ndikimeve në mjedis që mund të ndodhin si dhe masat e propozuara për parandalimin dhe zvogelimin e tyre në mjedis, pastaj masat për rehabilitimin dhe sanimin e dëmeve pas përfundimit të projektit qoftë të tokës, ujit, apo ajrit kuptohet nëse janë dëmtuar mbi normat e lejuara sipas ligjeve të Republikës të Kosovës dhe konventave ndërkombëtare për mjedis. Projektet e tilla duhet të jenë të ballancuara në rrafshin ekonomik, pastaj në atë social dhe mjedisor. Vetëm në këtë mënyrë duke i marrë parasysh këta tre parametra ne sigurojmë një zhvillim ekonomik të mirefillt dhe një mjedis të qëndrueshëm.



3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

Raporti i VNM-se do të bazohet në ligjin Nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis i publikuar në gazetën zyrtare 2/2023 është bazë për kornizën ligjore që do të promovojë një ngritje të mjedisit të shëndetshëm për komunitetin me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Projekti i propozuar nuk shtrihet në zonën e ndieshme mjedisore, sipas observimit dhe pamjes së lokalitetit nga personi i licencuar, për lëmin e Mbrojtjes së Mjedisit. Leja leshohet duke u bazuar në Planin e Biznesit për Naser Nazif Salihaj për ngritjen e qendres për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe duke u bazuar në informatat e prezantuara dhe nga gjendja e observuar në teren.

4.1. Përshkrimi i lokacionit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM-s. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në teren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në koordinatat 42.4333° N, 21.0333° E. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të Kosovës. Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore dhe bujqësia është një nga prioritetet zhvillimore të komunës.

Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore - malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën

rrafshinore. Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me Shtimen me rrugë të asfaltuara. Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, sipas rezultateve preliminare të publikuara të mërkurën nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), ka rezultuar se Komuna e Shtimes ka 27 mijë e 288 banorë.(13.839 meshkuj dhe 13.449 femra). Nga këto shifra del se prej 34 komunave, në të cilat është bërë regjistrimi i popullsisë, Shtimja është komuna e njëzet e katërt me radhë për ka numri i banorëve.

Kryqëzimi i akseve rrugore të rëndësishme në relacionet Prizren - Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj-Shkup janë segmente me rëndësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. Komuna e Shtimes kufizohet me Komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës).

Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina), 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale, këtë segment duhet ruajtur dhe zgjeruar edhe gjatë hartimit të Planit Gjeneral Urbanistik .






Fig.1. Harta e komunës së Shtimes



4.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i qendres për grubullimin e mbeturinave metalike i takon Zyres Kadastrale të Komunës së Shtimes, Zona kadastrale Rashincë, ngastra Nr. **00831-3**, sipas kopjes së planit përfshinë një sipërfaqe prej 1833 m², është në një largësi prej 5 km nga qyteti i Shtimes dhe ka një lartësi mbidetare rreth 550 m nga niveli i detit. Është tokë e klasit të katërt dhe ndodhet në vendi i quajtur Terbesh. Territeni është i rrafshët dhe është shumë i përshtatshëm për këtë veprimtari.

Kjo qendër do të shtrihet në pjesën e njësisë kadastrale **P-72809072-00831-3** në Rashincë me sipërfaqe prej $S=1833 \text{ m}^2$ dhe ndodhet në thellësi prej 50 metrave nga rruga që lidhë dy magjistralet Shtime-Prishtinë dhe Shtime-Ferizaj. Ngastra është në pronësi private në emër të Naser Nazif Salihaj dhe është në zonën ku lejohet ngritja e kësaj qendre grumbulluese.

Objekti i banimit ndodhet relativisht afër nga kjo pike, por duke patur parasysh që kjo qendër nuk do të grumbullojë makina të vjetra të cilat posedojnë fluide (lende djegëse dhe vajera të ndryshme), të cilat bëjnë pjesë në grupin e materieve të rrezikshme dhe që potencialisht do ta ndikojnë mjedisin negativisht. Kjo është edhe arsyeja kryesore pse pronari ka hequr dorë nga pranimi i kësaj makinave për ta mbrojtur dhe kursyer mjedisin nga ndotja. Ky fakt do të shërbejë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse, që mund të ketë ndikime mjaft të vogla në mjedis.

Hapësira e qendres është rrafshët dhe është e shtruar me zhavor të ngjeshur mirë. Ka të gjithë infrastrukturen bazë si rrjet ujësjellesi, pastaj kanalizim, rryme elektrike dhe rrugë të asfaltuar. Posedon një dhomë kontejner ku punetoret mund ta shfrytëzojnë për pushim. Gjithashtu posedon edhe toalet të veçanta për punetoret që do të kujdesen për këtë qendër grumbulluese.



Shkala 1:1000 Ortofoto OFF

KOORDINATAT		
Nr.	X	Y
6281	7507828.927	4699760.863
6282	7507843.16	4699734.659
6294	7507883.224	4699786.727
6295	7507849.497	4699770.746
6305	7507897.593	4699758.648

Y=7507858.743 X=4699759.992 (KSREF01)

X=4698349, Y=507856 UTM Zona=34N

$\lambda=42.43743$ $\phi=21.09552$ (WGS 84)

Pikat kontrolli deri 5km

Kodi=FE26 Y=7511204.441, X=4697638.19, Ho=559.365 He=604.5646| Dist=3.96Km
 Kodi=FE27 Y=7509287.173, X=4695998.567, Ho=585.486 He=630.6914| Dist=4.02Km
 Kodi=ST11 Y=7503430.015, X=4698770.537, Ho=631.156 He=676.3425| Dist=4.54Km
 Kodi=ST13 Y=7503614.216, X=4699920.002, Ho=566.9 He=612.0804| Dist=4.25Km








Fig. 2. Harta e situacionit me koordinata



Fig. 3. Ortofoto e lokacionit të qendres grumbulluese të mbeturinave metalike



4.3. Përshkrimi i aktiviteteve ne qendren per grumbullimin e mbeturinave metalike

Kryesisht e tërë veprimtaria e qendrës te grumbullimit te mbetjeve metalike ka të bëjë me grumbullimin e ketyre e mbeturinave metalike qe sigurohen nga tregu Kosovar . Vlen të theksohet se kjo qendër do te grumbullon vetem mbeturina metalike qe vijnë nga sektore te ndryshem qofshin ato te amviserise apo edhe te industrise por duke perjashtuar ne menyre rigoroze makinat automobilistike, per shkak te rrezikut qe mund te sjellin ato ne aspektin e mbrojtjes se shendetit publik por edhe mjedisit.

Kjo qender ka per qellim qe te sherbej vetem si nje destinacion tranzit pasi ne momentin e pare qe sigurohet nje sasi e caktuar, perafersisht nje kamion ajo do te ngarkohet dhe do te transportohet ne vendin e shitjes qofte brenda vendit, qofte jashte vendit.


Ka tipe të ndryshme te mbeturinave metalike dhe materialeve tjera të ngurta dhe i tërë sistemi është sistemuar për përcjelljen e të dhënave. Pra nga hyrja e mbeturinave, kontrolli i gjendjes së tyre, regjistrimet e tjera seleksionimi dhe deri te deponimi dhe destinimi.

Pronari eshte i obliguar qe të bëjë selektimin sipas natyrës dhe përshkrimit sipas skemës përbërëse të mbeturinave të ngurta.

Posaçërisht kompania duhet të posedoj personel të përgatitur teknikisht dhe se duhet të kenë njohuri lidhur me mbrojtjen e mjedisit si dhe të zbatojne parimin e mos qëndrimit me një vend të mbetjeve por sa ma shpejt të përcillen në destinacionin e caktuar.

Gjatë grumbullimit grumbujt nuk guxojnë të ngriten me material lartë, të kene pjertësi të madhe si grumbuj si dhe ngarkesa në peshë për m². Kategorizimi i metaleve sipas llojit te metalit behet si vijon:

- Hekuri dhe çeliku
- Alumini
- Bakri
- Plumbi
- Zinku, nikeli, etj.
- Objektet e përziera: Çmontohen pajisjet për të ndarë komponentët metalikë nga plastikë, qelq, goma, etj.



Qendra e grumbullimit dhe çmontimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës posedon një përgaditje teknike relativisht të kompletuar për një veprimtari të tillë. Posedon një vinq 4.0 t dhe një 1.5 t që i shërben për ngritjen e automjeteve në lartësi, si dhe makinën për prerjen e metaleve (gërshërë)

Hapësira e qendrës për grumbullimin e mbetjeve metalike është me sipërfaqe të rregullt katërkendeshe brenda ngastrës në të cilën nevojitet të bëhet skicimi apo plani i situacionit.

Qendra duhet të ketë tabela me mbishkrim të shënuar sipas materialit mbeturinë të klasifikuar si: alumin, inoks, bakër, plastikë, elektrombeturina etj. Tabelat me mbishkrim të shënuar dhe të vendosur në sipërfaqet e ndara mundë të ndërrohen varesisht nga perberja e materialit mbeturinë.

4.4. Proceset që kryhen në qendrën grumbulluese

Nga masa e përgjithshme e grumbullimit nga pervoja e pronarit rezulton se perberja e materialit është siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

a) metale	96%
b) qelq	0.5 %
c) plastikë	1 %
d) gomë	1 %
e) të tjera	1.5 %

Mbeturinat metalike në përgjithësi përbëhen nga metalet që bëjnë pjesë mbi 96% të sasisë së përgjithshme të këtyre mbeturinave, si që janë Fe, Al, Cu, Pb etj.

Keto mbeturina kanë vlerë të veçantë dhe bëjnë pjesë në resurse natyrore të paripërtitshme, prandaj klasifikimi dhe akumulimi i tyre pas ruajtjes së resurseve natyrore dhe përfitimeve ekonomike mundëson edhe kursimin e energjisë.

Për administrimin dhe menaxhimin sa më të mirë të qendrës grumbulluese do të kryhen këto veprime: pranimi, peshimi, klasifikimi, prerja dhe shitja.

Në vijim po e paraqesim skemën e trajtimit të mbeturinave metalike.






Fig.4. Skema e trajtimit të mbetjeve metalike nga "NIKI REC" Sh.P.K.

4.5. Vlera investive e projektit

Sipas projektit të hartuar të qendres për grumbullimin e mbeturinave metalike me një sipërfaqe prej 1833 m², që parashihet të ngritet në lokacionin e lartepërmendur vlera investive e kësaj qendre do të jetë 80,600.00 €

Nr	Lloji i investimit	Shuma në euro
1	Punët tokësore (mihja, rregullimi i terrenit – bazës punuese) i kryen vet kompania.	10,200 €
2	Makinat operationale fikse	20,400 €
3	Makinat mobile	50,000 €
	Total	80,600 €



5. PERSHKRIMI I GJENDJES DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Dispozitat ligjore të republikës së Kosovës dhe Standardeve Evropiane që parashikohen të zbatohen edhe në Kosovë, që në formë të përgjithshme po i cekim edhe në këtë raport të VNM-se.

Raporti i plotë i VNM-së që përmbanë elaboratin e kompletuar të VNM-së për një operator ekonomik do të përpilohet në rastet kur operatori ka ndikim të drejtëpërdrejtë apo të përhershëm në: ndikimet në shëndetin e popullatës, ndryshimet në popullatë, peisazh, në zona rekreative, shkarkimet në tokë, ujë, ajër, ndikimi i zhurmës dhe vibrimeve, nivelet e ndikimit të rrezatimit jonizues, ndikimi në florën dhe faunën, trashëgiminë natyrore p.sh. humbja e varieteteve bimore, dhe shtazore, dëmtimi i relikteve gjeologjike në kontekstin paleontologjik dhe fiziko-gjeografik, ndryshimet e cilësisë dhe sasisë së ujit, degradimi i resurseve natyrore etj. Në këto raste operatorët ekonomik do të monitorohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë-MMPH.



5.1. Përshkrimi i mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë për hartimin e raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhëna relevante që kanë të bëjnë më të dhënat ekzistuese morfologjike, pedologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

5.2. Relievi

Morfologjia e terrenit ku është pozicionuar qendra për grumbullimin e mbeturinave metalike karakterizohet me një relief kryesisht të rrafshët e cila gjendet në lartësi mbidetare afër 550 m. Gjatë kryerjes së punëve ndërtimore për vendosjen e objekti është vërejtur se në aspektin gjeologjik kemi të bëjmë me një tokë humusore të zezë deri në thellësinë 2 m, pastaj çfaqet një shtresë toke me përbërje fosilesh e cila shtresë nuk është eksploruar duke pasur parasysh se edhe vëllimi i punëve nuk ka qenë aq i madh në mënyrë që bëhet ndonjë studim gjeologjik më i hollësishëm.



5.3. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik dhe tektonike janë faktorë dominant të cilët definojnë lëvizjen e ujrave sipërfaqësorë dhe atyre nëntokësorë. Në distance me pak se dy km nga qendra per grumbullimin e mbeturinave kalon lumi Shtimjanja qe derdhet ne lumin Sitnica. Prurjet e ketij lumi jane me te medha gjate stines se vjeshtes dhe dimrit kurse gjate stines se veres kemi nje zvogelim te ndjeshem te volumit te tij.

Ujërat sipërfaqësore paraqiten vetën në sezonën e reshjeve atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrale. Thellësia e nivelit të ujerave nëntokësore është e rreth 12 m në sezonën e verës kurse në dimër ai nivel ngritet në 3 m nën sipërfaqe. Ky ndryshim i nivelit të ujerave është konstatuar nga shpuarja e një pusi me diameter Ø1000mm.

5.4. Pedologjia


Në aspektin pedologjik, në vendin ku ndodhet qendra ka toka të kultivuara me të lashta bujqësore me një relief të rrafshët fushor. Gjithashtu në afërsi të objektit shihet një bimësi e mirë e zhvilluar për shkak se toka është pjellore e cila është e mjaftueshme në këtë lokacion. Në lokalitetin ne fjale toka ka ngjyrë zezë të mbyllët e aty këtu të çelët. Lagështinë e merr nga të reshurat atmosferike. Siç u cekë më lart tokat kane ngjyrë kafe në të zezë. Tokat me ngjyrë zezë biologjikisht janë aktive dhe kryesisht përdoren si toka bujqësore, edhe pse janë toka pjellore janë të vështira për punë.

5.5. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës , nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Deri më tani nuk është hasur ndonjë bimësi endemike qe eshte në zhdukje.

5.6. Bimësia dhe vegjetacioni

Përbërja gjeologjike dhe pedologjike e tokës kushtet klimatike dhe relievi ndikojnë në zhvillimin e bimësisë. Në këtë pjesë kryesisht dominon bimësia e tipit klimatik kontinental, pra mbretëron bimësia gjethrënëse. Dominojnë kulturat bujqësore si gruri, misri, bari etj. Kryesisht bimët i takojnë tipit kserofit që do të thotë bimë që përshtaten kushteve klimatike me ndërrime stinore.



5.7. Bota Shtazore - Fauna

Në vendin ku është dizajnuar qendra për mbeturinat metalike ekziston një faunë e rëndomtë për kushtet klimatike të Kosovës në përgjithësi. Duhet të përmenden zvarraniket, brejtësit, insekte të ndryshme që e përbejnë zingjirin ushqyes, pastaj disa lloje të shpendeve etj. Nuk ka ndonjë specie që është e mbrojtur me ligj.

5.8. Peisazhi



Karakteristikat e peisazhit të hapësirës së analizuar, paraqesin njërin nga elementet për të saktësuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionet objekt-mjedis. Karakteristikë është se këtu kemi të bëjmë me një peisazh ku dominon toka bujqësore dhe pjesërisht me shtepi banimi. Efektet vizuale (peisazhet) janë kritere me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Kur bëhet fjale për qendrën në fjale nuk kemi të bëjmë me prishje të peisazhit të përgjithshëm, pasi që kjo qendër është largë nga rruga kryesore dhe nuk paraqet ndonjë shemti për mjedisin.

5.9. Zhurma

Zhurma, si element i natyrës së veprimtarisë së lartëcekur ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Zhurma për zonën e banuar duke i pasur për bazë largësitë e objekteve të banimit, është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 90 dB sipas standardeve ndërkombëtare dhe ligjit për zhurmën Nr. 02/L-102. që është në fuqi dhe është miratuar nga Parlamenti Republikës së Kosovës. Ky aktivitet gjeneron zhurmë kryesisht nga puna me makineri për prerje apo ngarkim por është në kufijtë e lejuar pasi që qendra është e hapur kryesisht prej 08:00 deri në 18:00 kur lejohet një nivel pak më i lartë i zhurmës sesa në pjesën e mbremjes që fillon nga ora 19:00 deri në ora 22:00 apo të natës që fillon pas orës 22:00 deri në ora 07:00 të mëngjesit.

Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën:

Zhurma	Distanca(m)			
	10	50	100	500
90dB-niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25



6. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

6.1 Ndikimet në vendbanim dhe popullatë

Në afërsi të lokalitetit ku do të zhvillohe grumbullimi i mbeturinave metalike ka objekte banimi ku ne pronesi te tyre eshte pronari i kompanise “NIKI REC” SH.P.K dhe vellezerit e tij nga te cilet pronari ka pelqimin dhe miratimin e tyre. Shtepite tjera jane ne nje distance relativisht te madhe dhe nuk do te ndikohen nga aktivitetet e kesaj qendre. Zhvillimi i kesaj veprimtarie për këtë rajon ka efekt pozitiv për popullatën sepse do të ketë nevojë për punëtore shtesë.

Kurse ndikimet negative ne mjedis mund të jenë, vetem në rast se operatori, nuk i perfill kriteret mjedisore.



6.2. Ndikimi ne ndotjen e ujit dhe tokes

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vie deri te degradimi i vlerave themelore e karakteristike të saja. Gjatë funksionimit kontinual të qendrës grumbulluese te mbeturinave metalike dhe komponentët e tyre, ndotja e dheut është si pasojë e ketyre mbeturinave qe vijnë nga klientet e ndryshëm.

Ndotja ndodhë edhe nga sedimentimi i ndotjeve që sjellen përmes ujërave sipërfaqesore që vijnë nga sipërfaqet operacionale të kompleksit të qendrës grumbulluese dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të qendrës grumbulluese. Pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vie si pasojë e derdhjeve të pa kontrolluara të derivateve nga makinerite qe punojne aty. Duhet perseritur edhe njehere se ndotja e dheut nuk do te ndodhe ne permasa te medha pasi qe pronari ka vendosur qe makinat e vjetra qe posedojne fluide te ndryshme nuk do te pranohen ne kete qender pa u hequr te gjitha vajerat dhe derivatet nga makina, perfshire dhe baterite qe posedojne acid sulfurik te holluar dhe elktroda te plumbit

6.3. Ndikimi ne ndotjen e ajrit

Gjatë funksionimit kontinuel të qendrës për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe mund të theksojmë se aktiviteti i këtij kompleksi nuk shoqërohet me ndotje të theksuar të ajrit, e vetmja ndotje mund të ndodh nga automjetet transportuese që transportojnë



mbeturina ne në këtë deponi. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponenteve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin në fjalë.

6.4. Mbeturinat e Ngurta

Mbeturinat e ngurta urbane që gjenerohen nga punonjësit e kësaj qendre do të mbledhen nga Ndërmarrjen Publike Rajonale (NPR)” Pastërtia”-Njësia në Shtime që është kompetente për mbledhjen e tyre.


Kurse sa i përket mbeturinave të ngurta që aksidentalisht sillen në qender dhe paraqesin rrezikë për shëndetin publik dhe mjedisin atëherë pronari është i obliguar që ato t'i deponojë në qese të materialeve të rrezikshme dhe t'i trajtojë në mënyrë të veçantë duke e kontraktuar ndonjë kompani që bën mbledhjen dhe asgjësimin e materialeve të tilla.

6.5.Ndikimet në Peisazh

Lokaliteti ku planifikohet të ngritet kjo qender nuk është i dukshëm pasi që në një njerëz ane është i rrethuar me mur relativisht të lartë dhe në pjesën tjetër ka disa drunje të larta të mbjellur para shumë kohës që e bëjnë qendren grumbulluese për mbeturinat metalike të padukshme, prandaj nuk ka ndikim negativ sa i përket prishjes së përgjithshme të peisazhit.

6.6. Ndikimi në florë dhe faunë

Gjatë fazës së përgatitjes për vendosjen së qendres grumbulluese në këtë lokalitet si dhe gjatë kohës së funksionimit, për pasojë do të kemi dëmtimin e florës, por e cila duhet të rikultivohet pas mbylljes së kësaj qendre si mëse për rehabilitimin e mjedisit. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga rajoni në fjalë dhe do të dislokohet në terrenin e përafërt që i përshkruhet asaj



7. MASAT PER MBROJTJEN E MJEDISIT

7.1. Masat parandaluese për zvoglimin e ndikimeve ne ajer

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve të qendrës grumbulluese duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese (pirunëve) dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngeta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetët e punës të jetë sa më kualitativ.

Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i djegies së lëndëve djegëse është e nevojshme të sigurohen kushtet për djegie sa më kualitative

7.2. Masat parandaluese për zvogelimin e ndikimeve ne toke dhe uje

Mbrojtja e hapësirës jashtë qendres nga ndotësit siq është lym i cili shkaktohet me rastin e të reshurave atmosferike bëhet në atë mënyrë që hapësira të jetë e drenazhuar, të cilët përveq se do ta mbrojnë qendren grumbulluese nga vërshimet, do t'i mbrojnë edhe ujërat nga ndotësit eventual siq janë vajrat e ndryshëm qe mund te rrjedhin nga makinat transportuese.


Prandaj për pastrimin e ujërave gjatë të reshurave duhet të krijohen pusët sedimentuese të cilët do të shërbenin për sedimentimin e materialeve të ngurta si dhe seperatori për pastrimin e ujit të ndotur nga rrjedhja eventuale e vajrave motorike nga makinerite qe jane pjese e qendres grumbulluese.

Duhet patur kujdes që pusët sedimentuese dhe seperatori të pastrohen rregullisht.

Ujërat e zeza duhet sëpari të trajtohen në gropën septike ku bëhet neutralizimi ndotësve, e cila kohë pas kohe pastrohet nga kompani të licencuara, për t'i ikur tejmbushjes.

Kurse sa i perket tokes dhe ujerave pronari duhet te kete kujdes qe produktet e tilla edhe pse konsiderohen plehra qe jane te dobishme per kulturat bujqesore ato mund te kene efekt negativ ne toke ne koncentrimet e medha e qe nuk perjashohet edhe mundesia e infiltrimit te tyre ne ujerat nentokesore nese rrjedhjet aksidentale jane te medha.

Skema teknologjike për trajtimin e ujërve





Ujërat nga separatori nuk quxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivatë të naftës mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.

Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen në recipient të pastërta. Seperator i vajrave dhe gropa septike duhet rregullisht të pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT

Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proceseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues. Monitorimi i ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës duhet të veshet me kujdes nga ndonjë rrjedhje aksidentale të fluideve tjera si vajra dhe produkte tjera të naftës.



9. MASAT REHABILITUESE PER SANIMIN E GJENDJES PAS MBYLLJES SE VEPRIMTARISE

9.1. Rikultivimi teknik

Në bazë të ligjeve relevante të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të sipërfaqes, investitori është i obliguar që tokës t'i kthehet pamja e mëparshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike-pedologjike në lokalitetin e qendres duhet konstatuar se cilat pjesë iu janë nënshtruar dëmtimeve nga aktivitetet prodhuese. Për këtë arsye duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësitë e sanimit të efekteve të pa volitshme si dhe rikultivimin e kësaj pjese.

Pas përfundimit të punëve prodhuese fillon rikultivimi teknik i sipërfaqeve tokësore të degraduara. Degradimi i sipërfaqeve gjatë punimeve prodhuese shkon deri në atë masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj në këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet mihja selektive e humusit dhe vendosja direkte në sipërfaqet punuese ku janë kryer punimet d.m.th. duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi teknik të kryhet njëkohësisht gjatë zhvillimit të punimeve në objekt.

Pra me përfundimin e shfrytëzimit të lokalitetit nga punimet operacionale, fillon shtresimi i dheut dhe humusit në këto hapsira. Nëse konstatojmë se shterpa nuk i plotëson kërkesat kualitative për rikultivim kemi cekë edhe më parë, duhet të konsultohen ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe të sillet sasia e dheut nga një vend tjetër me qëllim të suksesit të rikultivimit.

9.2. Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.



Toka është njëri prej elementeve të këtij mjedisi të cilës përveç që i ndërrohet destinimi primar, pëson degradim të rëndë, deri në zhdukjen e profilit pedologjik të saj. Kjo paraqet formën më të rëndë të dëmtimit të tokave.


9.3. Rikultivimi biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e shfrytëzuara dhe të dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siqë janë:

Toka, uji, ajri, flora dhe fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarine bujqësore, blegtorale etj. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit.

Bimët të cilat mbillen duhet t'u përshtaten kushteve klimatike dhe se me zhvillimin e tyre i japin një pamje të bukur peisazhit. Këto bimë adaptohen lehtë dhe janë rezistuese ndaj dëmtuesve biologjik.

Kjo duhet të bëhet me konsultimin me ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe me autoritetin e ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë.



10. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE

- Përshkrimi i shkurtër

Nga masa e përgjithshme e grumbullimit nga pervoja e pronarit rezulton se perberja e materialit është siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

a) metale	96%
b) qelq	0.5 %
c) plastikë	1 %
d) gomë	1 %
e) te tjera	1.5 %

Mbeturinat metalike në përgjithësi përbëhen nga metalet që bëjnë pjesë mbi 96% të sasisë së përgjithshme të ketyre mbeturinave, si që janë Fe, Al, Cu, Pb etj.

Keto mbeturina kanë vlerë të veçantë dhe bëjnë pjesë në resurse natyrore të parapërtitshme, prandaj klasifikimi dhe akumulimi i tyre pas ruajtjes së resurseve natyrore dhe përfitimeve ekonomike mundëson edhe kursimin e energjisë.

Për administrimin dhe menaxhimin sa më të mirë të qendrës grumbulluese do të kryhen këto veprime: pranimi, peshimi, klasifikimi, prerja dhe shitja.


• Ndikimet në mjedisë

Përshkrimi i aktiviteteve të cilat kanë ndikim të theksuar në mjedis:

- Ndikimi në ndotjen e ujit dhe tokës

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të viejë deri të degradimi i vlerave themelore e karakteristike të saja. Gjatë funksionimit kontinual të qendrës grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentët e tyre, ndotja e dheut është si pasojë e ketyre mbeturinave që vijnë nga klientet e ndryshëm.

Ndotja ndodhë edhe nga sedimentimi i ndotjeve që sjellen përmes ujërave sipërfaqesore që vijnë nga sipërfaqet operacionale të kompleksit të qendrës grumbulluese dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotës nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të qendrës grumbulluese. Pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e derdhjeve të pa kontrolluara të derivateve nga makinerite që punojnë aty.



Duhet perseritur edhe njehere se ndotja e dheut nuk do te ndodhe ne permasa te medha pasi qe pronari ka vendosur qe makinat e vjetra qe posedojne fluide te ndryshme nuk do te pranohen ne kete qender pa u hequr te gjitha vajerat dhe derivatet nga makina, perfshire dhe baterite qe posedojne acid sulfurik te holluar dhe elektroda te plumbit

- **Ndikimi ne ajer**

Gjatë funksionimit kontinuel të qendrës për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe mund të theksojmë se aktiviteti i këtij kompleksi nuk shoqërohet me ndotje të theksuar të ajrit, e vetmja ndotje mund të ndodh nga automjetet transportuese që transportojnë mbeturina në këtë deponi. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponenteve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin në fjalë.

- **Mbeturinat e ngurta**

Mbeturinat e ngurta urbane qe gjenerohen nga punonjesit e kesaj qendre do te mblidhen nga Ndërmarrjen Publike Rajonale (NPR) " Pastërtia"-Njësia në Shtime qe eshte kompetente per mbledhjen e tyre.



Kurse sa i perket mbeturinave te ngurta qe aksidentalisht sillen ne qender dhe paraqesin rrezike per shendetin publik dhe mjedisin ateherë pronari eshte i obliguar qe ato t'i deponoje ne qese te materialeve te rrezikshme dhe t'i trajtoj ne menyre te veçante duke e kontraktuar ndonje kompani qe ben mbledhjen dhe asgjesimin e materialeve te tilla.

• **Masat mjedisore**

Masat parandaluese për zvogelimin e ndikimeve ne toke dhe uje

Mbrojtja e hapësirës jashtë qendres nga ndotësit siq është lym i cili shkaktohet me rastin e të reshurave atmosferike bëhet në atë mënyrë që hapësira të jetë e drenazhuar, të cilët përveq se do ta mbrojnë qendren grumbulluese nga vërshimet, do t'i mbrojnë edhe ujërat nga ndotësit eventual siq janë vajrat e ndryshëm qe mund te rrjedhin nga makinat transportuese.

Prandaj për pastrimin e ujërave gjatë të reshurave duhet të krijohen pusët sedimentuese të cilët do të shërbenin për sedimentimin e materialeve të ngurta si dhe



seperator për pastrimin e ujit të ndotur nga rrjedhja eventuale e vajrave motorike nga makinerite që janë pjese e qendres grumbulluese.

Duhet patur kujdes që pusët sedimentuese dhe separatori të pastrohen rregullisht.

Ujërat e zeza duhet sëpari të trajtohen në gropën septike ku bëhet neutralizimi ndotësve, e cila kohë pas kohe pastrohet nga kompani të licencuara, për t'i ikur tejmbushjes.

Kurse sa i përket tokës dhe ujërave pronari duhet të ketë kujdes që produktet e tilla edhe pse konsiderohen plehra që janë të dobishme për kulturat bujqesore ato mund të kenë efekt negativ në tokë në koncentrimet e mëdha e që nuk përjasohet edhe mundësia e infiltrimit të tyre në ujërat nëntokësore nëse rrjedhjet aksidentale janë të mëdha.



11. Përfundimi

Mund të konstatojmë: se qendra për grumbullimin mbeturinave metalike nga "NIKI REC" SH.P.K. nuk e dëmton mjedisin (tokën, ajrin, ujin dhe resurset tjera natyrore) në fazën e tanishme.

Duke u bazuar në faktet nga terreni dhe konsulta me aplikuesin, njëherit nuk ndikon negativisht në resurset natyrore, njerëzore dhe i plotëson kushtet për të ushtruar veprimtarinë e saj.

Ka hapësirë të mjaftueshme për të ushtruar këtë veprimtari dhe ka mundësi reale për infrastrukturë të mirëfilltë. Ndikimi në ambientin tokësor është i vogël dhe si i tillë mund të neglizhohet.

Po ashtu ndikimi në ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësor është fare i vogël. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, dhënien e pëlqimit mjedisor sipas kërkesës së pronarit Naser Nazif Salihaj.



12. LITERATURA

1. Faqja zyrtare e komunës së Shtimes
2. Legjislacioni Mjedisor-mmph-rks.org
3. Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit (2011).
4. Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011), Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave (2013-2022).
5. Marsden S. (2008), Strategic Environmental Assessment in International and European Law. Beder S. 2006. Environmental principles and policies. An interdisciplinary introduction. Earthscan.
6. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.
7. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC-zyra në Kosovë.
8. AMMK-Raportet Zyrtare mbi Gjendjen e Mjedisit –annk-rks.org
9. European commission (2010). Communication from the Commission EUROPE 2020. A strategy for smart, sustainable and inclusive growth. COM(2010)2020 final. Brussels.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për
Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI
lëshon:

Nr. i licencës: 23/19/24


LICENCË

Raif BYTYQI
Dr.sc.Inxh.i mjedisit

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM- së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë

z. Liburn Aliu
Ministër i MMPHI



SHTOJCA:

▪ Vlera investive e projektit

Sipas projektit të hartuar të qendres për grumbullimin e mbeturinave metalike me një sipërfaqe prej 1833 m², vlera investive do të jete:

Nr	Lloji i investimit	Shuma në euro
1	Punët në terren (mihja, rregullimi i terrenit – bazës punuese) i kryen vet kompania	10200 €
2	Makinat operacionale fikse	20400 €
3	Makinat mobile	50000 €
	Total	806000 €

▪ Dokumentacioni bashkëngjitur VNM-së:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata e pronësisë
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit, nga gjeodeti i licencuar
- Pëlqimi i komunal për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas PZHK

